



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 325 prot.

Tiranë, më 25.02.2019

**VENDIM**

**Nr.18, datë 25.02.2019**

***“PËR FILLIMIN E MBIKËQYRJES SË ORIENTUAR MBI ZBATIMIN E LIGJIT NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL, NË KONKURRIMET E PLANIFIKUARA PËR T’U ZHVILLUAR NGA DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS PUBLIKE GJATË VITIT 2019, ME PROCEDURAT E PRANIMIT NË NIVELIN EKZEKUTIV NË SHËRBIMIN CIVIL, LËVIZJES PARALELE, NGRITJES NË DETYRË DHE PRANIMIT NË TRUPËN E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES (TND)”***

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me Vendimin Nr. 1, datë 03.01.2019, *“Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2019”*, ka miratuar planifikimin vjetor të procesit të mbikëqyrjes, duke përcaktuar llojin dhe objektin e mbikëqyrjeve dhe subjektet që do të kontrollohen gjatë këtij viti.

Në këtë planifikim, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që kanë procedurat e rekrutimit në lidhje me: **a)** pranimin në nivelin ekzekutiv në shërbimin civil; **b)** lëvizjen paralele; **c)** ngritjen në detyrë dhe **ç)** pranimin në trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND), në institucionet e administratës shtetërore, për të siguruar një shërbim civil të qëndrueshëm, profesional dhe të bazuar në meritë, ç’ka përbën edhe qëllimin e ligjit për nëpunësin civil, është parashikuar zhvillimi i *“mbikëqyrjes së orientuar”*, përcaktuar në nenin 14/1, germa “c”, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, me qëllim mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2019.

Për këtë arsye,

në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11/1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/*

*inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, si dhe në zbatim të Vendimit Nr. 1, datë 03.01.2019, “*Për miratimin e planit vjetor të punës të institucionit për vitin 2019*”, të Komisionerit, me qëllim që të mbikëqyr zbatimin e ligjit në administrimin e procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar, nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2019;

#### **VENDOSA:**

1. Fillimin e mbikëqyrjes së orientuar, me objekt mbledhjen e informacionit në drejtim të funksionimit të procedurave të konkurrimeve të planifikuara për t’u zhvilluar nga Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2019.
2. Ngritjen e grupit të mbikëqyrjes, me këtë përbërje:

<b>1. Altin Shumeli</b>	Drejtor i Mbikëqyrjes
<b>3. Behare Hoxha</b>	Inspektor (Anëtar)
<b>4. Matilda Idrizaj</b>	Inspektor (Anëtar)
<b>5. Ina Skënderi</b>	Specialist IT (Anëtar)

2. Anëtarët e grupit të mbikëqyrjes, së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të paraqiten dhe të kërkojnë çdo dokumentacion të nevojshëm, në të gjitha institucionet që nxjerrin akte administrative, apo kryejnë procedura të caktuara, që kanë lidhje me procesin e rekrutimit, të tilla si testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.
3. Me këtë vendim të njihet grupi i mbikëqyrjes dhe Departamenti i Administratës Publike.
4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit për të zbatuar këtë vendim.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**